

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit K. H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2650/2014 të datës 02.12.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e prokurorit të shtetit në Prizren Elfete Purova, të akuzuarit dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit Jur. Dip. B. P. nga Prizreni, me datë 18.01.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

K. H. nga i ati R. dhe e ëma F. e lindur Sh., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer fakultetin e infermierisë, infermier, i martuar, baba i një fëmije, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 11.04.2014, në Prizren në shtëpinë e tij familjare, komisioni i autorizuar i KEDS – Distribucioni në Prizren, me qëllim që ti sjell vetit pasuri të kundërligjshme si shfrytëzues i shërbimeve komunale përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarës së energjisë elektrike pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, ashtu që shfrytëzon energjinë elektrike me njëjësor i cili pllombat shtetërore i ka të manipuluar, numëruesi është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes në numëror, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 445.39 €.

Kësodore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 320 të KPK i shqipton dënimin dhe atë:

D Ë N I M M E K U S H T

Ashtu që vërteton

- dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

- dënimin me gjobë në lartësi prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara KEDS – Dsitribucioni në Prizren nëpërmjet autorizuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 € në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2650/2014 të datës 02.12.2014, kundër të akuzuarit K. H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit në Prizren deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar nën numrin PP/II.nr.2650/2014 të datës 02.12.2014, kundër të akuzuarit K. H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK dhe atë duke pasur parasysh faktin se këtu i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë e cila është në pajtim me provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza. Andaj propozoi gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar deklaroi se e mbështet fjalët e prokurorit të shtetit dhe parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari deklaroi se në kohën e kur është bërë kontrolli në shtëpinë e tij është hasur në keqpërdorim të njehsorit elektrik pasi që në atë shtëpi jetojnë edhe anëtarët tjerë të familjes dhe të gjitha faturat janë në emër të kryefamiljarit. Mirëpo pasi që ditën kritike ka qenë vetë gjatë kryerjes së kontrollit e ndjen përgjegjësinë dhe pranon fajësinë për veprën penale objekti i akuzës. Kjo është hera e parë që del para organeve të drejtësisë dhe nga gjykata kërkon që të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që shkojnë në favor të tij ashtu që ndaj tij të shqiptoj një dënim sa më të butë, pasi që është mbajtës i familjes dhe mjetet financiare siguron nga puna e tij. Premton para gjykatës se në të ardhmen do të kushtoj kujdes të shtuar këtyre aseteve në mënyrë që mos të bie ndesh me ligjin.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike në datë 11.04.2014, në shtëpinë e tij familjare e cila gjendet në Prizren, i akuzuari K. H. me shifër të konsumatorit 9030507 me numër të njehsorit elektrik 35005297, pas një kontrolli nga ana e zyrtarëve të KEDS – Distribucioni në Prizren, është vërtetuar se i akuzuari përfiton nga shërbimi komunal që furnizohet përmes rrjetit përçues dhe shpërndarjes së energjisë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që shfrytëzon energjinë elektrike me njehsor i cili pllombat shtetërore i ka të manipuluar, numëruesi është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes në numëror, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS – Distribucioni në Prizren ka shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata nuk ka administruar provat, pasi që nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk i

ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, premtimi se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla, është i gjendjes së dobët ekonomike dhe mbajtës i familjes, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1880/2014 të datës 18.01.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.